


ISBN: 978-608-4573-22-7  
10.21520/C.3-2-2016



**SCfSD '16**

Scientific Challenges for Sustainable Development

# Conference Proceedings

Vol.2



INTERNATIONAL  
UNIVERSITY OF STRUGA



INTERNATIONAL  
UNIVERSITY OF STRUGA

UNIVERSITETI NDËRKOMBËTAR I STRUGËS

# Book of Proceedings International University of Struga

Volume 2

ISBN 978-608-4573-22-7

DOI 10.21520/C.3-2-2016

Nr.3 / Korrik, 2016

**ORGANIZING COMMITTEE:**

**Aleksander Biberaj** - Rector of International University of Struga

**Anastas Angjeli** - Rector of Mediterranean university of Albania

**Mevlud Dudić**- Rector of International University of Novi Pazar

**Hilmi Ibar** - Trakya University

**Sabahudin Komoni**- University of Pristina

**Shyqeri Kabashi**- Business University College

**Ligor Nikolla**- University of Tirana

**Vehbi Ramaj**- International University of Struga

**COORDINATORS:**

**Armen Kadriu**- International University of Struga

**Guximtar Rushani**- International University of Struga

**Biljana Ciglovska** – International University of Struga

**Senada Lačka**– International University of Struga

**Florida Veljanoska** – International University of Struga

**Jeton Shaqiri** – International University of Struga

**Bleri Dauti** – International University of Struga

**Majlinda Axhiu** – International University of Struga

**Nazmije Merko** – International University of Struga

**CONFERENCE SECRETARIAT**

**Marinela Shkurta**– International University of Struga

**Abidin Trena**– International University of Struga

E-mail: [iusconference2016@eust.edu.mk](mailto:iusconference2016@eust.edu.mk)

THE EFFECT OF CULTURE ON FIRM'S CSR ENGAGEMENT .....	6
INVESTMENTS IN THE REPUBLIC OF KOSOVO .....	19
HOW LEADERSHIP CONFLICTUAL BEHAVIOR AFFECTS PARTNERSHIP FROM THE PROSPECTIVE OF DECISION MAKING .....	35
ENVIRONMENTAL MANAGEMENT AND STANDARDS FOR STORAGE OF MINERALS IN KOSOVO .....	42
NJË VËSHTRIM TEORIK I TRANZICIONIT SI KONKURENCË INSTITUCIONALE .....	51
KONCESIONET DHE KONTRATAT KONCESIONARE NË SISTEMIN JURIDIK TË REPUBLIKËN E KOSOVËS .....	59
MORTGAGE LOAN CONSUMERS AND THE PROTECTION FRAMEWORK IN ALBANIA .....	71
VËSHTRIM PËR MËNYRAT E SIGURIMIT TË PASURISË NGA VLERA E VOGËL NË VLERË MË TË MADHE.....	82
AGRICULTURAL TRADE REGULATION IN THE INTERNATIONAL TRADING SYSTEM.....	90
INVESTIMET E HUAJA DIREKTE GJATË KRIZËS FINANCIARE GLOBALE .....	103
MENXHIMI I PËRFORMANCËS NË NVM-TË KOSOVARE.....	116
STARTING A BUSINESS: COMPARATIVE ANALYSIS BETWEEN THE REPUBLIC OF ALBANIA AND THE REPUBLIC OF ROMANIA .....	130
UDHËHEQJA, PERSONALITETI I UDHËHEQËSIT, VETITË DHE AFTËSITË E UDHËHEQËSIT POTENCIAË SI DHE AUTORITETI I TIJ .....	143
RREGULLAT DHE DISPOZITAT E BAZEL III NË PËRPUTHJE ME KREDITIMIN E NVM-VE NË EUROZONË DHE NË VENDE TË TJERA.....	153
REFORMS, REGULATION AND COMPETITION IN THE ELECTRICITY PRODUCTION IN ALBANIA .....	166
ЭФЕКТИТЕ ОД ЦЕФТА-2006 ВРЗ ЕКОНОМИЈАТА НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА.....	176
MARKETINGU NDËRKOMBËTAR I VERËRAVE NË KONTEKSTIN E MSA-SË NË MES TË KE-SË & KOSOVËS.....	191
MANAGEMENT OF SATISFACTION AND CONSUMER BEHAVIOR IN COMMERCIAL BANKS IN MUNICIPALITY OF VUSHTRRI .....	205
DIVERSIFICATION OF FUNDING AS A SOLUTION TO FINANCIAL SUSTAINABILITY IN A NON- FOR-PROFIT ORGANIZATION .....	214
ЗГОЛЕМУВАЊЕ НА КАПАЦИТЕТИТЕ НА ПРЕТПРИЕМАЧИТЕ ВО ФУНКЦИЈА НА ОСТВАРУВАЊЕ НА ПОГОЛЕМ РАСТ И РАЗВОЈ НА БИЗНИСОТ.....	220
SPECIFIKAT E SJELLJES SË KONSUMATORËVE NË TREGUN PËR KONSUM PERSONAL.....	234
VENDIMARRJA NË NDËMARRJET AFARISTE.....	252
THE APPLICATION OF E-COMMERCE IN THE DEVELOPMENT OF TOURISM ENTERPRISES IN STRUGA, OHRID AND BITOLA .....	260

FISCAL DECENTRALIZATION – PREFERENCE OR STAGNATION IN LOCAL SELF-GOVERNMENT IN MACEDONIA .....	270
NJOHJE ME MODELET E MBAJTJES SË REZERVAVE NË NDËRMARRJE DHE ZBATIM PRAKTIK I TYRE .....	278
FORMAT E ORGANIZATËS AFARISTE NË KOSOVË DHE RREGULLAT E DETYRIMEVE TATIMORE PËR SECILEN ORGANIZAT .....	284
SISTEMET E INFORMACIONIT NË MENAXHIMIN E NDËRMARRJEVE TELEKOMUNIKUESE ...	295
THE ROLE OF INTERNET MARKETING AND THE EFFECT ON ENTERPRISE DEVELOPMENT ..	308
THE IMPACT OF MARKETING IN DEVELOPING OF SMALL AND MEDIUM ENTERPRISES OF MARKET ECONOMY IN KOSOVO .....	328
MODELET E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE NË NDËRMARRJET PUBLIKE DHE PRIVATE TË QYTETIT TË SKENDERAJT .....	344
THE NOTION OF CORPORATE SECURITY IN THE SCIENTIFIC LITERATURE .....	349
CHALLENGES OF ENTREPRENEURSHIP, MANAGEMENT AND CORPORATE FINANCE AFTER THE GLOBAL FINANCIAL CRISIS FROM THE PERSPECTIVE OF POST-ECONOMIC CRISIS OF 1930.....	362
MARKETINGU DHE ZHVILLIMI EKONOMIK NË NDËRRMARJET E VOGLA DHE TË MESME NË KOSOVË .....	370
LIGJI I ZBATUESHËM MBI INSTITUTIN E TRASHËGIMISË REFERUAR RREGULLORES (EU) NR 650/2012 .....	381
PROVA E KUNDËRT NË PROCESIN PENAL .....	395
EUROPIAN INTEGRATION PROCESS AND THE JUDICIARY: THE ALBANIAN JUDGE ROLE .....	408
TRAFIKIMI NJERËZOR DHE KRIMI I ORGANIZUAR .....	415
KRIMI I ORGANIZUAR DHE TRAFIKIMI I PERSONAVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR .....	427
NEVOJA DHE PRITSHMËRITË PËR REFORMËN NË DREJTËSI NË SHQIPËRI .....	438
LIRIA DHE BARAZIA NË BALLKANIN PERËNDIMOR .....	448
ПАЗВОЈ НА ДЕЛОВАНОТО ПРАВО .....	458
REFORMAT NË PROCEDURËN PENALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DREJT STANDARDEVE EVROPIANE.....	472
СЕМЕЈНОТО ПРАВО КАКО ДЕЛ ОД ПРАВНИОТ СИСТЕМ НА ЕДНА ДРЖАВА .....	486
TRAFIKIMI ME NJERËZ NË TERRITORIN E GJKATËS THEMELORE TË MITROVICËS - 2010-2014.....	502
TERRORIZMI, DISA PËRKUFIZIME, LLOJET DHE MASAT LIGJORE QË DUHEN MARRË PËR PARANDALIMIN DHE LUFTËN NDAJ TIJ .....	516

**LIGJI I ZBATUESHËM MBI INSTITUTIN E TRASHËGIMISË REFERUAR  
RREGULLORES (EU) Nr 650/2012**

**Dr. Besmir ALUSHI**

Universiteti Mesdhetar I Shqipërisë

**Msc. Ejona XHEMALAJ**

Universiteti Mesdhetar I Shqipërisë

**ABSTRAKT**

Gjithçka njerëzore është e destinuar të lind, të ndryshoj dhe të shuhet. Transmetimi nga një brez në tjetrin është pikërisht ajo e cila në të drejtën private europiane do të quhet trashëgimi. Nuk do të kishim qytetërim pa histori dhe trashëgimi. Ajo që lidh vdekjen me jetën është pikërisht trashëgimia dhe pasojat e ardhura prej saj. Platoni do të pyeste se çfarë lind nga jeta dhe pergjigja do të referohej tek "vdekja". Sokrati do shkonte më tej duke pyetur në mënyrë kontraverse për jeten. Sebesi, pasuesi i Sokrati do të përcaktonte që do të ishte vete "jeta". Krijimi i Bashkësisë Europiane dhe nevoja e përfaqësjes së legjislacioneve civile të Shteteve Anëtare është një ideal shumë i bukur, por jo aq i lehtë për t'u realizuar. Kjo për faktin se sistemet ligjore të një pjese të madhe të shteteve anëtare të këtij Bashkimi ndryshojnë nga ato të pjesës tjetër. Çështja e mënyrës së rregullimit të trashëgimisë ka qenë objekt diskutimesh të zgjatura dhe në konferencen ndërkombëtare të Hagës qysh nga viti 1893. Kështu, Instituti i së Drejtës Ndërkombëtare në Hagë, që në 1928 përpunoi Konventën për konfliktet e ligjeve dhe juridiksionit në fushën e trashëgimisë dhe të testamenteve, dhe në vazhdim përmendim Konventën mbi konfliktet e ligjeve në fushën e formës së diponimeve testamentare.

Përpjekjet e vazhdueshme mbi institutin e trashëgimisë vazhduan duke u kodifikuar me rregulloren Nr 65/2012 e njohur ndryshe si Bruksel IV. Në terma shumë të përgjithshme, ajo siguron se ligjet e shtetit (vendit) ku i ndjeri ishte "banor i përhershëm" (i cili duhet të jetë një shtet anëtar i BE-së) do të rregullojnë se si pasuria do të transferohet, përveç rastit nëse i ndjeri ka zgjedhur të aplikoj ligjin e kombësisë së tij.

**Fjalët kyçe:** *Trashëgimi, Rregullore Nr 650/2012 Bruksel IV, Bashkimi Evropian.*

## HYRJE

Tridhjetë vjet më parë mendohej se trashëgimia ishte ndoshta çeshtja më e vështirë dhe e paeksploruar nga e drejta ndërkombëtare private. Kjo pasi sistemet ligjore të një pjese të madhe të shteteve anëtare të këtij Bashkimi ndryshojnë nga ato të pjesës tjetër. Kështu, për shembull sistemi ligjor i Anglisë, Irlandës së Veriut, Republikës së Irlandës dhe Gjilbraltarit, që emërtohet *the common law* (e drejta e përbashkët), ndryshon nga sistemi i së drejtës civile, që është rregullimi ligjor i Francës, Belgjikës, Italisë, etj. Ndikime të së drejtës së përbashkët hasen dhe në Skoci si dhe në Qipro ku ekziston një sistem që është përzierje e sistemit ligjor otoman me të drejtën e përbashkët.

Sot, në vendet e Bashkësisë Europiane po bëhen përpjekje që të përpunohet dhe të hyjë në fuqi një instrument i vetëm lidhur me trashëgiminë dhe testamentet, dispozitat e të cilit të zbatohen në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, duke tejkaluar të gjitha veshitësitë e dikurshme. Në rekomandimet që Parlamenti European bën për trashëgimitë dhe testamentet thuhet se ky parlament, çmon se akti legjislativ që do të miratohet, duhet të rregullojë çështjet me karakter të përgjithshëm në lëmin e së drejtës së zbatueshme. Posaçërisht, Parlamenti European çmon se: ligji i caktuar nga akti legjislativ që do të miratohet, pavarësisht nga natyra dhe lokalizimi i sendeve, duhet të jetë kompetent për të rregulluar të gjithë trashëgiminë, nga çelja e saj deri në kalimin e trashëgimisë trashëgimtarëve. Instrumenti i ardhshëm duhet të ketë karakter *erga omnes*, dmth që duhet të jetë i zbatueshëm edhe në rastin kur ligji i caktuar prej tij është ligji i një shteti të tretë, me synim bashkërendimin e sistemit komunitar të konfliktit për trashëgiminë.

Në ditët e sotme një vend të rëndësishëm në të drejtën ndërkombëtare private lidhur me trashëgiminë zë Konventa lidhur me ligjin e zbatueshëm për trashëgimitë për shkak vdekjeje, e përfunduar në Hagë në 1989, konventë e cila, do të shmangte mundësinë e zbatimit të ligjeve të ndryshme për pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme. Në të janë futur koncepte të reja (si vendqëndrimi i zakonshëm etj) dhe theksohet se parimi *lex rei sitae*, për pasuritë e paluajtshme, konsiderohet se i ka kaluar koha dhe duhet braktisur. Por, përveç këtyre instrumenteve ndërkombëtare, Bashkimi European ka përpunuar një sërë instrumentash që kanë karakter zonal dhe kanë lidhje me trashëgiminë. Kështu psh, Komisioni European ka përgatitur dhe botuar më 1 mars 2005 një material që u quajt "Libri i blertë", në hyrjen e të cilit theksohet se "pranimi i një

instrumenti europian lidhur me trashëgiminë ishte një nga përparësitë e Planit të Veprimit të Vjenës më 1998". Më vonë, Parlamenti Europian miratoi një rezolute me rekomandimet për Komisionin lidhur me trashëgiminë dhe testamentet. Eric Jane në 2002 shkruante së asgjë nuk pasqyron identitetin kulturor të një sistemi juridik më qartë se përcaktimi juridik i marrëdhënies midis individit dhe vdekjes.<sup>192</sup> Marrëdhënia midis kulturës së një vendi dhe të drejtës së trashëgimisë të këtij vendi nuk mund të mohohet. Sociologjia ka dëshmuar, se ndryshimet në të drejtën e trashëgimisë, rrjedhin deri në një farë mase nga perceptimet e ndryshme kulturore të veprimtarëve politikë, prandaj e drejta e trashëgimisë me të cilën është lidhur trashëgimlënësi mund të ndikojë në vlerat kulturore dhe sociale të trashëgimlënësit për një trashëgimi të drejtë.<sup>193</sup>

### 1. ASPEKT KRAHASUES

Për sa i përket ligjit të zbatueshëm: cilat kritere do të shfrytëzohen për të zgjedhur ligjin e zbatueshëm (*lex successionis*) për trashëgiminë? Ato shtete që janë të prirura ndaj sistemit unitar, monist të rregullimit i referohen zakonisht një kriteri subjektiv, personal, siç mund të jetë shtetësia e trashëgimlënësit, banimi apo qëndrimi i tij në kohën e vdekjes etj., kurse shtetet e tjera i referohen një kriteri objektiv, siç është vendi i ndodhjes së pasurisë.

- Prej kohësh kriteri mbizotërues, *sidomos* në Evropë, ka qenë *lex nationalis*, ose ligji i Shtetit, shtetas i të cilit ka qenë trashëgimlënësi. Por, me kalimin e kohës, vendin e tij po e zë "vendqëndrimi i zakonshëm i trashëgimlënësit". Ky kriter është përmendur fillimisht në Konventën e Hagës të 5 tetorit 1961 lidhur me tagrat e autoriteteve për mbrojtjen e të miturve dhe ligjin e zbatueshëm, por deri sot nuk dihet të kemi një përkufizim të këtij koncepti nëpërmjet ndonjë instrumenti ndërkombëtar.

Për rastet kur personi nuk e zgjedh vetë ligjin e zbatueshëm për trashëgiminë e vet, për përcaktimin e tij Konventa në fjalë pranon si kriter edhe ligjin e vendqëndrimit të zakonshëm ose të shtetësisë. Neni 3.1 i kësaj Konvente parasheh se "trashëgimia rregullohet nga legjislacioni i shtetit në të cilin ka pasur qëndrimin e tij të zakonshëm trashëgimlënësi në çastin e vdekjes, në qoftë se trashëgimlënësi ka pasur shtetësinë e këtij shteti". Por, në rast se trashëgimlënësi ka

<sup>192</sup>. E. Jane, Die kulturelle Dimension des Rechts, ihre Bedeutung fuer das Internationale Privatrecht and die Rechtsvergleichung te *RabelsZ* 67(2003)311-230.

<sup>193</sup>. Anatol Dutta, Succession and Wills in the Conflict of Laws on the Eve of Europeanisation, te *Rabels Z* 73, 2009, fq. 561.



qëndruar në një vend të caktuar në mënyrë të pandërprerë mbi pesë vjet, ky vend do të konsiderohet si vendi i qëndrimit të tij të zakonshëm dhe do të jetë ligji i këtij vendi ai që do të rregullojë trashëgiminë.

Në rrethana të jashtëzakonshme, në ato raste që në çastin e vdekjes trashëgimlënësi paraqiste lidhje haptazi më të ngushta me shtetin, shtetësinë e të cilit kishte (Neni 3.2 i Konventës), do të zbatohet legjislacioni i këtij shteti. Në rastet e tjera, ligji i zbatueshëm për trashëgiminë do të jetë ai i shtetit, shtetas i të cilit ishte trashëgimlënësi, me përjashtim të rasteve që në çastin e vdekjes ai paraqiste lidhje më të ngushta me një shtet tjetër, rast në të cilin do të zbatohet legjislacioni i shtetit të fundit (neni 3.3 I Konventës).

Edhe në Konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja në çështje civile e tregtare (1966) përdoret termi “vendqëndrim i zakonshëm”, por më pas, Konferenca hoqi dorë përfundimisht nga përdorimi i “banimit”, duke arsyetuar se zbatimi i këtij kriteri shkakton probleme interpretimi dhe cilësimi në lidhje me legjislacionet kombëtare. Sipas Raportit shpjegues të Konventës së 1 qershorit 1970 për njohjen e shkurorëzimeve dhe ndarjeve të ligjshme, Bellet dhe Goldman shprehen për interpretimin e “qëllimit” (synimit) si një nga synimet kryesore të banimit, por përmendin edhe se dy elementët e vendqëndrimit të zakonshëm janë: a) qëndrimi në territorin e një Shteti; dhe b) natyra pak a shumë e përhershme e këtij qëndrimi. Por ishte sukcesi i Konventës së Hagës mbi aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijëve (25 tetor 1980) që i dha shkas zhvillimit të konceptit të “vendqëndrimit të zakonshëm”, si një nga konceptet baze të së drejtës ndërkombëtare private. Gjykata Europiane e Drejtësisë ( Luksenburg), në vendimit e 2 prillit 2009 në çështjen “A”, C-523/07, përpiket të japë një përkufizim sa më të plotë të konceptit të “vendqëndrimit të zakonshëm” duke u shprehur se “koncepti i ‘qëndrimit të zakonshëm’, sipas nenit 8(1) të Rregullores, duhet të interpretohet se nënkupton vendin që pasqyron një shkallë integrimi të fëmijës në mjedisin familjar e shoqëror. Për këtë qëllim duhet të mbahet posaçërisht parasysh: kohë-vazhdimi, rregullshmëria, kushtet dhe arsytet e qëndrimit në territorin e Shtetit Anëtar dhe lëvizja e familjes në këtë shtet, shtetësia e fëmijëve, vendi dhe kushtet e ndjekjes së shkollës, dijenia e gjuhës dhe marrëdhënia familjare që shoqëronte fëmijën në këtë Shtet. I përket gjykatës kombëtare që, duke patur parasysh të gjitha rrethanat specifike të çdo rasti të veçantë, të vendosë për qëndrimin e zakonshëm të

fëmijës”. Duke patur parasysh këtë vendim të Gjykatës Europiane të Drejtësisë, mund të themi se elementët kryesore për përcaktimin e vendqëndrimit të zakonshëm të një subjekti janë:

- i. Nga ana faktike: asnjë rrethanë nuk është e mjaftueshme dhe vendimtare, prandaj duhen marrë parasysh të gjitha rrethanat;
- ii. Vendqëndrimi i zakonshëm nuk është i njëjtë me banimin apo qëndrimin e përhershëm (permanent residence);
- iii. Vendqëndrimi është qendra e gravitetit të jetës së personit, e interesave të tij familjare, profesionale e shoqërore;
- iv. Qëllimi për të qëndruar nuk është një element i mjaftueshëm apo vendimtar;
- v. Kërkohej një fare kohëzgjatje e qëndrimit, por nuk është e domosdoshme që ky qëndrim të jetë i vazhdueshëm. Një qëndrim i përkohshëm në një vend tjetër nuk sjell detyrimisht edhe ndryshimin e vendqëndrimit të zakonshëm;
- vi. Personat mund të kenë vendqëndrim të zakonshëm në disa shtete, ose të mos kenë vendqëndrim;

Në të drejtën ndërkombëtare private, për zgjidhjen e çfarëdo problemi, është pasur gjithmonë parasysh lidhja më e ngushtë që ka marrëdhënia juridike me një gjykatë të caktuar dhe legjislacionin e saj. Në fushën e trashëgimisë, vendqëndrimi i zakonshëm pasqyron lidhjen më të ngushtë midis pasurisë trashëgimore dhe rregullimit të saj. Çdo kriteri tjetër, në mënyrë që të përmbushë kërkesat e një zgjidhjeje të drejtë të trashëgimisë, do të duhej t'i bëheshin “korrigjime”.

- Një tjetër kriter për përcaktimin e ligjit të zbatueshëm për trashëgiminë mund të jetë edhe vullneti i trashëgimlënësit. Në të drejtën civile autonomia e vullnetit është e njohur, por në të drejtën trashëgimore kjo autonomi, nga shumica e shteteve, nuk njihet. Vetëm në disa shtete testatorëve u njihet një e drejtë e kufizuar dhe e kushtëzuar për të përcaktuar ligjin e zbatueshëm për trashëgiminë e tyre. Kështu psh. sipas nenit 46.2 të Kodit Civil Italian “Subjekti... me deklaratë të shprehur në formë testamentare, mund t’ia nënshtrojë të gjithë trashëgiminë ligjit të shtetit ku qëndron

Konventa e Hagës mbi ligjin e zbatueshëm për trashëgiminë për shkak vdekjeje u njeh personave të drejtën që, nën disa kushte, të zgjedhin vetë ligjin që do të rregullojë trashëgiminë e tyre të ardhshme. Neni 5.1 i kësaj Konvente parasheh se “një person mund të zgjedhë ligjin e një shteti

të caktuar për rregullimn e tërësisë së trashëgimisë. Ky disponim hyn në fuqi vetëm në rast se ky person, në çastin e këtij caktimi ose në çastin e vdekjes, kishte shtetësinë e këtij shteti ose kishte në të vendqëndrimin e tij të zakonshëm”.<sup>194</sup> Pra, sipas kësaj Konvente, për rregullimin e trashëgimisë së tij të ardhshme, një person ka të drejtë, që kur është gjallë, të zgjedhë ligjin e zbatueshëm. Ky përcaktim duhet të shprehet me anë të një deklarate të bërë në përputhje me kërkesat formale në dispozitat e pasurisë pas vdekjes. Megjithatë, e drejta e zgjedhjes së ligjit të zbatueshëm nuk njihet në një sërë vendesh<sup>195</sup>, por kjo mund të sjellë shqetësime për ata persona, që ndryshojnë vendin e qëndrimit. Vendi ynë nuk është palë e kësaj Konvente, prandaj nuk mund të pretendohet zbatimi i saj nga gjykatat tona. Por, sikur Shqipëria të ishte palë e Konventës, zgjidhjet që sugjeron Konventa në fjalë janë të ndryshme dhe do të mbeteshin në juridikion të gjykatës të përcaktojë se cilat do të konsideroheshin lidhje më të ngushta të trashëgimlënësit dhe si do të provoheshin këto. Sidoqoftë, kjo është një çështje që do të mbetet gjithmonë në vlerësimin e gjykatës. Por termi “vendqëndrimi i zakonshëm”, që përdoret në Konventa dhe në përgjithësi në Europë, është i papërcaktuar saktë për të drejtën shqiptare. është e vertetë që ky term është nënkuptuar ndryshe në sistemet e së drejtës civile dhe ndryshe në sistemet e *common law*, por prej disa dhjetëvjeçarëve ai ka hyrë në të gjitha Konventat e Hagës dhe kjo ka bërë që tashmë të jetë bërë një nocion realist dhe i lehtë për t’u përcaktuar, duke i korresponduar qëndrës së jetës dhe interesave të trashëgimlënësit.

Sipas nenit 14 të Kodit tonë Civil vendqëndrimi është vendi ku personi ndodhet për të kryer punë ose detyra të caktuara, për të vazhduar një shkollë ose një kurs të caktuar, për tu mjekuar, për të vuajtur një dënim penal, dhe për raste të tjera të kësaj natyre, kurse banimi është vendi ku personi, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm të ndodhjes së pasurisë apo realizimit të interesave të veta, qëndron zakonisht ose në të shumtën e kohës (neni 12 KC). Pra, qendra e jetës dhe e interesave, sipas legjislacionit tonë, është vendi i banimit dhe jo ai i qëndrimit. Sipas C.M. Bianca “*qëndrimi është vendi ku personi ka fiksuar banesën e tij të zakonshme*” me të cilën nënkupton “vendin e banimit të zakonshëm, d.m.th. vendin ku subjekti jeton normalisht

<sup>194</sup>. Në këtë Konventë, si dhe në disa të tjera, përdoret termi “vend-qëndrimi i zakonshëm” dhe jo “vend-banimi” (“habitual residence” apo “residence habituelle”). Është pretenduar se termi “vend-banimi” nuk është i saktë dhe prandaj është parapëlqyer përdorimi i termit “vend-qëndrim i zakonshëm”.

<sup>195</sup>. Nuk njihet p.sh. në Austri, Qipro, Francë, Greqi, Irlandë, Letoni, Lituani, Luksenburg, Poloni, Portugali, Sllovaki, Slloveni, Suedi dhe në Republikën Çeke.

intimitetin e tij dhe të familjes se tij". Në të njëjtën mënyrë konceptohet qëndrimi edhe në të drejtën franceze etj. Sic shihet midis konceptimit tonë dhe atij europian në përgjithësi të termit "vendqëndrim" ka ndryshime dhe termi "vendqëndrim i zakonshëm" është një kriter i së drejtës ndërkombëtare private dhe jo i së drejtës civile. Duhet theksuar se disa shtete tashmë termin "vendqëndrim i zakonshëm" e kanë përfshirë në legjislacionin e tyre. Në Zvicër për këtë term nënkuptohet "vendi ku personi fizik qëndron kohën më të gjatë, edhe kur dihet, në ndryshim me banimin, se ky qëndrim do të jetë i përkohshëm".

## 2. BRUKSEL IV/Rregullorja (EU) Nr 650/2012.

Bruksel IV tani është nën efekt.<sup>196</sup> "A do të ketë sukses? Kjo, mbetet ende një pyetje e drejtë. Përveç çështjeve të saj të brendshme, suksesi i rregullores do të pengohet nga fakti se Britania e Madhe vendosi të mos t'i bashkohet Bruksel IV. (Irlanda dhe Danimarka gjithashtu vendosen kundër bashkimit.)

### • Çfarë është Bruksel IV?

Emri i duhur i Brukselit IV është "Rregullorja (EU) Nr 650/2012 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e datës 4 korrik 2012 mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve dhe pranimin e zbatimit të instrumenteve autentike në çështjet e trashëgimisë dhe në krijimin e një Çertifikate Europiane të Trashëgimisë.<sup>197</sup> Në terma shumë të përgjithshme, ajo siguron se ligjet e shtetit (vendit) ku i ndjeri ishte "banor i përhershëm" (i cili duhet të jetë një shtet anëtar i BE-së) do të rregullojnë se si pasuria do të transferohet, përveç rastit nëse i ndjeri ka zgjedhur të aplikoj ligjin e kombësisë së tij. Brukseli IV aplikohet në mënyrë të plotë për pasuritë e personave që kanë vdekur më 17 gusht 2015 ose pas kësaj date, përveç neneve 77 dhe 78 të cilat aplikohen nga 16 janar 2014, dhe nenet 79, 80 dhe 81 të cilat aplikohen nga 5 korrik 2012. Siç u përmend më lartë, Mbretëria e Bashkuar, Irlanda dhe Danimarka nuk i janë bashkuar Bruksel IV. Ajo do të zbatohet, për trashëgimlënës të cilët kanë qenë banorë rezident në vendet e tjera të BE-së, si dhe për pasuritë e vendosura në vende të tjera anëtare të BE-së.

### • Harmonizimi i Ligjeve

Nevoja për harmonizim nëpër Evropë (ose, në të vërtetë, në të gjitha vendet – i cili ishte qëllimi i pranuar i Konventës së Hagës mbi Ligjin e Aplikueshëm në pasuritë e të ndjerit)- është

<sup>196</sup>. Zbatohet për vdekje në ose pas 17 gusht 2015.

<sup>197</sup>. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32012R0650>.

serioze. Pa harmonizim, konfliktet midis ligjeve të vendeve të ndryshme mund t'a bëjë gati të pamundur për të realizuar një plan të pasurive. Një rezident i Shtetit A, i cili është shtetas i Shtetit B, me një shtëpi pushimi në Shtetin C, dhe një bashkëshort ose fëmijët në shtetet D, E dhe F, mund të kenë ligje nga çdo një apo më shumë nga këto shtete për të aplikuar mbi pasurinë e tyre.

Disa shtete mund të zbatojnë një ligj ndaj pasurive të luajtshme dhe një ligj tjetër në pronën e paluajtshme (të tilla si ligji i situs<sup>198</sup>). Për të shtuar një shtresë tjetër kompleksiteti, ajo mund të jetë e mundur për një (ose më shumë) nga vendet që pretendojnë juridiksion për të aplikuar një formë të "ligjit të konflikteve" (ose "së drejtës ndërkombëtare private") që përfshin "renvoi"<sup>199</sup> që do të thotë se juridiksioni i pohuar nuk mund të zbatojë edhe rregullat më të zakonshme të saj nëse konstaton se ligji i "situs" së një aktivi mund të referohen përsëri në juridiksionin e pohuar. Si një shembull ekstrem, ligje krejtësisht të ndryshme mund të aplikohen thjesht duke u bazuar aty ku gjykata pohon juridiksion.<sup>200</sup>

198. Përcaktimi i situs: Në ligj, "situs" (latinisht për pozicionin apo vendndodhjen) e pronës është aty ku prona është trajtuar si e vendosur për qëllime ligjore. Kjo mund të jetë e rëndësishme gjatë përcaktimit se cilat ligje zbatohen për pronën, pasi "situs" i një objekti përcakton situs lex, që është, ligji i aplikueshëm në juridiksionin ku objekti është i vendosur, të cilat mund të ndryshojnë nga lex fori, ligji i zbatueshëm në juridiksionin ku është sjellë një veprim ligjor. Për shembull, pasuria e paluajtshme në Angli është subjekt i ligjit anglez, pasuria e paluajtshme në Skoci është subjekt i ligjit skocez, dhe pasuria e paluajtshme në Francë është subjekt i ligjit francez. Është thelbësor përcaktimi i "situs" të një objekti, dhe situs lex, sepse ka diferenca thelbësore mes ligjeve në juridiksione të ndryshme qeverisëse.

199. Përcaktimi i Renvoi: Proçes me të cilin, në lidhje me ndonjë konflikt të ligjeve që lind, një gjykatë miraton rregullat e një juridiksioni të huaj. Në disa raste, rregullat e shtetit të huaj mund t'i referohet përsëri gjykatës së ligjit të forumit aty ku rasti është duke u dëgjuar. Renvoi Termi i referohet gjithashtu rregullave që, në një padi nga një jorezident mbi një shkak që lind në nivel lokal, kapaciteti i padisë përcaktohet nga ligji i jo rezidentit të regjistruar, në vend të ligjit vendor. Doktrina e renvoi ndiqet rrallë në Shtetet e Bashkuara dhe ka qenë gjithashtu e refuzuar nga një numër i madh studiuesish të huaj ligjor.

200. Për shembull, ndërmjet Anglisë dhe Francës, ligji i trashëgimisë që do të zbatohet për një qytetar të Anglisë i cili vdes duke banuar në Francë, do të varet nga fakti nëse një kërkesë është sjellë në një gjykatë angleze ose në një franceze, vetëm për shkak të rregullave të ndryshme që ato gjykata do të zbatojnë për çështjet e zgjedhjes-së ligjit. Nëse është sjellë në një gjykatë franceze, gjykata së pari do të shikoj ligjin anglez si ligji i kombësisë, por do

Sipas pikës 7: Në zonën europiane të drejtësisë, qytetarët duhet të jenë në gjendje të organizojnë trashëgiminë e tyre paraprakisht. Të drejtat e trashëgimtarëve dhe legatarëve, të personave të tjerë të afërt me të ndjerin dhe të kreditorëve të trashëgimisë, duhet të jenë të garantuara në mënyrë efektive.

Neni 1 thekson se Rregullorja do aplikohet vetëm në "trashëgiminë për pasuritë e personave të vdekur." Ajo më poshtë rreshton kategori për të cilën rregullorja nuk do të aplikohet: për statusin e një personi, të drejtat martesore, mirëbesimin, dhurimin, sigurimin, aktivet e tjera përfituese të caktuara, detyrimin e mirëmbajtjes, detyrimet tatimore, aksionet dhe marrëveshtjet e transferimit të kufizuar. Qëllimi i Rregullores është të gjejë një mënyrë përmes së cilës ligji i një shteti të aplikohet për trashëgiminë (pa ndonjë renvoi). Ligji i zgjedhur është ai i vendbanimit të përhershëm të trashëgimlënësit. Ky vend duhet të përcaktohet, sipas pikës 23, si vijon:

Për të përcaktuar vendbanimin e përhershëm, autoriteti që ka të bëjë me trashëgiminë, duhet të bëjë një vlerësim të përgjithshëm të rrethanave të jetës të të ndjerit gjatë vitit pararendës nga vdekja e tij dhe në kohën e vdekjes së tij, duke marrë parasysh të gjitha elementët relevante faktike, në veçanti kohëzgjatjen dhe rregullsinë gjatë prezencës së të ndjerit në Shtetin në fjalë, gjithashtu kushtet dhe arsyet për këtë prani.

Pika 24 sqaron se: Në raste të caktuara, përcaktimi i vendbanimit të personit të vdekur mund të sjelli kompleksitet. Një rast i tillë mund të lindi kur i ndjeri për arsye profesionale ose ekonomike është zhvendosur, në shumicën e rasteve për një kohë të gjatë, për të jetuar jashtë vendit për të punuar por mban një lidhje të ngushtë dhe të qëndrueshme me shtetin e tij të origjinës. Për të ndjerin qëndron mundësia, në varësi të rrethanave të çështjes, të konsiderohet ende të ketë vendbanimin e tij të zakonshëm në shtetin e tij të origjinës në të cilin janë vendosur interesat e familjës së tij dhe jeta e tij sociale .

---

të zbuloni se ligji anglez do të aplikoj ligjin francez si ligji i vendbanimit. Kështu, një veprim i sjellë në një gjykatë franceze do të përfundoj me zbatimin e ligjit francez (duke përfshirë trashëgiminë e detyruar). Rezultati i kundërt do të ndodhë në qoftë se veprimi është sjellë në një gjykatë angleze, gjykatësi do të shikoj ligjin francez, ligjin e vendbanimit, dhe do të zbuloj se ligji francez do të aplikoj ligjin anglez, ligjin e shtetësisë. Kështu, një gjykatë angleze do të përfundoj duke aplikuar ligjin anglez (jo të trashëgimisë së detyruar).

Kreu III, Neni 21 parashikon: Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në këtë Rregullore, ligji i zbatueshëm për trashëgiminë si një e tërë do të jetë ligji i shtetit në të cilën i ndjeri ka pasur vendbanimin e tij të përhershëm në kohën e vdekjes. Por, teksti i Rregullores nuk e përkufizon termin "vendbanim i përhershëm".

Paragrafi i dytë (dhe i fundit) i nenit 21 parashikon: Nëse është e qartë në të gjitha rrethanat e rastit, që në kohën e vdekjes i ndjeri ishte haptazi i lidhur më ngushtë me një shtet tjetër nga shteti ligji i të cilit do të ishte i zbatueshëm sipas paragrafit 1. Ligji i aplikueshëm për trashëgiminë, do të jetë ligji i shtetit tjetër. Pa ndonjë përkufizim në tekstin e Rregullores, duhet të merret parasysh efekti i dy paragrafëve të përshkruara më sipër për t'i dhënë kuptim termit. Një përjashtim shumë i rëndësishëm për zbatimin e përgjithshëm të ligjit të vendbanimit të përhershëm është se një person mund të zgjedh për të aplikuar ligjin e kombësisë se tij (pavarësisht vendbanimit të tij të përhershëm).

Siç parashikohet në nenin 22 të Rregullores: Një person mund të zgjedhë si ligj për të udhëhequr trashëgiminë e tij si një e tërë ligjin e shtetit, kombësinë e të cilit ai posedon në kohën kur është bërë zgjedhja apo në kohën e vdekjes.<sup>201</sup> Në fund të Rregullores, ka një numër nenesh (77-81) të cilat i kërkojnë vendeve anëtare të japin informacione në lidhje me ligjet e tyre për trashëgiminë dhe procedurat administrative. Këto dispozita hynë në fuqi në 2014 (77 dhe 78) dhe 2012 (79-81).

Neni 77 parashikon: Informacioni në dispozicion të publikut: Shtetet Anëtare, me synimin për të vendosur informacionin në dispozicion për publikun në kuadër të Rrjetit European të Gjyqësorit në çështjet civile dhe tregtare, duhet t'i sigurojnë Komisionit një përmbledhje të shkurtër të legjislacionit dhe procedurave lidhur me trashëgiminë e tyre kombëtare, duke përfshirë informacionin mbi llojin e autoritetit që ka kompetencë në çështjet e trashëgimisë dhe informacion për llojin e autoritetit kompetent për të marrë deklaratat e pranimit ose heqjes dorë nga trashëgimia, ose i një pjese të rezervuar. Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë gjithashtu listimin e fakteve shoqëruar me të gjitha dokumentat dhe/ose informacionin zakonisht të nevojshëm për qëllim të regjistrimit të pasurive të paluajtshme të cilat ndodhen në territorin e tyre. Shtetet Anëtare duhet të mbajnë informacion të përditësuar në mënyrë të përhershme. Kjo

<sup>201</sup>. Sipas nenit 22, në qoftë se ka më shumë se një kombësi, individit mund të zgjedhi çdo njëren prej tyre.

kërkesë për të siguruar (dhe në mënyrë të përhershme të rinovuar) një përmbledhje të ligjeve kombëtare lidhur me trashëgiminë, mund të jetë jashtëzakonisht e dobishme për ata që janë duke planifikuar mundësinë e pasurive shumë-juridiksionale, edhe pse është i këshillueshëm konsultimi me avokatin lokal në çdo rast.

- **Praktika Planifikimi**

Për ata që kanë klientët dhe/ose asete të vendosura në çdo një nga 28 shtetet anëtare të BE-së<sup>202</sup>, duke përjashtuar Mbretërinë e Bashkuar, Irlandën dhe Danimarkën, mund të kenë mundësinë për të përdorur Rregulloren në një mënyrë që mund t'i ofroj më shumë siguri. Për shembull, një studio ligjore në Londër sugjeron se klientët në Mbretërinë e Bashkuar mund të përfitojnë nga mundësia për të deklaruar në testamentet e tyre se do të jetë ligji i "kombësisë" ai që do të zbatohet. (Ashtu siç ndodh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku nuk ka një ligj për trashëgiminë "e Shteteve të Bashkuara", por vetëm e çdo një prej 50 shteteve dhe e Uashingtonit. Kështu edhe në Mbretërinë e Bashkuar, nuk ka asnjë ligj për trashëgiminë "e Mbretërisë së Bashkuar. Janë vetëm ligjet e trashëgimisë së Anglisë/ Uellsit, Skocisë ose Irlandës Veriore. Pra, një prej tyre do të duhet të jetë i specifikuar në testament.) Për këtë arsye ka një mundësi për personat me pronë në një Shtet Anëtar të Rregullores për të zgjedhur përmes vullnetit të tyre që ligji i shtetësisë do të aplikohet për trashëgiminë mbi pronën e tyre përkatëse në BE. Kjo mund të shmangë rregullat e detyruara lokale të së drejtës trashëgimore të cilat mund të ndryshojnë aplikimin.<sup>203</sup>

Edhe pse Rregullorja ka hyrë në fuqi në 17 gusht 2015, klientët janë në gjendje të shkojnë përpara dhe të vendosin këto dispozita në testamentet e tyre. Kjo aftësi për të zgjedhur ligjin kombëtar të personit është në fuqi gjithashtu në Zvicër. Edhe pse Zvicra nuk është pjesë e Bashkimit Europian. Në anën tjetër, edhe kjo këshillë është e paqartë. Neni 21 (1) thotë se,

<sup>202</sup>. Vendet anëtare, me vitin perkates të antarësimit : Austria (1995), Belgjika (1952), Bullgaria (2007), Kroacia (2013), Qipro (2004), Republika Çeke (2004), Danimarka (1973), Estonina (2004) Finlanda (1995), Franca (1952), Gjermania (1952), Greqia (1981), Hungaria (2004), Irlanda (1973), Italia (1952), Letonia (2004), Lituania (2004), Luksemburgu (1952) , Malta (2004), Holanda (1952), Polonia (2004), Portugalia (1986), Rumania (2007), Sllovakia (2004), Sllovenia (2004), Spanja (1986), Suedia (1995) dhe Mbretëria e Bashkuar (1973). [http://europa.eu/about-eu/countries/index\\_en.htm](http://europa.eu/about-eu/countries/index_en.htm).

<sup>203</sup>. Firma Boodle Hatfield, në [www.boodlehatfield.com/the-firm/articles/eu-succession-law.aspx](http://www.boodlehatfield.com/the-firm/articles/eu-succession-law.aspx)



përveç kur parashikohet ndryshe në këtë Rregullore, ligji i vendit të vendbanimit të përhershëm të trashëgimlënësit do të zbatohet. Për një banor anglez, ky është ligji anglez, dhe ai përfshin ligjin e "renvoi", sipas të cilit gjykatat angleze do t'i japin efekt zbatimit të ligjit francez për trashëgiminë mbi pronat e paluajtshme (për shembull, shtëpitë) të vendosura në Francë. (Neni 34 në mënyrë specifike parashikon se rregullat "renvoi" aplikohen si pjesë e sistemit të ligjit për trashëgiminë, për vende që nuk e kanë nënshkruar Bruksel IV.) Ky aplikim i "renvoi" do të thotë se banori anglez me një shtëpi pushimi në Francë nuk do të jetë në gjendje për të shmangur rregullat franceze të së drejtës trashëgimore të detyruar për aplikim. Rezultati mund të jetë i ndryshëm për një trashëgimlënës që, me rast vdekjen e tij, është banor i përhershëm në një shtet anëtar që ka nënshkruar Bruksel IV, e tillë si Franca.

Në një rast të tillë, neni 22, i cili i jep testatorit fuqinë për të zgjedhur si ligj për trashëgiminë ligjin e kombësisë së tij (pa "renvoi"), vlen. Neni 4 obligon gjykatat e Francës dhe të vendeve të tjera nënshkruese për të pranuar dhe për të mbrojtur zgjedhjen nga një rezident i Francës, me kombësi britanike, të ligjit anglez për trashëgiminë sipas nenit 22. Pra, një anglez i cili është banor i përhershëm në Francë mund të zgjedhi të aplikoj ligjin anglez për të gjithë pasurinë, duke përfshirë edhe shtëpinë e tij në Francë (dhe jo rregullat e detyrueshme franceze të së drejtës trashëgimore, të cilat mund të aplikohen ndryshe).

- **Pyetjet të hapura**

Çështjet e diskutueshme mbeten, të tilla si fakti që Rregullorja nuk ka ndonjë efekt mbi sendet e dhuruara dhe lë pyetje të hapura rreth mirëbesimit. Kjo mund të sjelli vështirësi kur pasuritë e një personi bien brenda një juridiksion që nuk e njeht plotësisht besimin dhe bartjen e aseteve sipas kushteve të tyre, e tillë si Franca. Në këtë fushë, më shumë se në çdo fushe tjetër, është praktikisht e pamundur për të harmonizuar rregullat ligjore ndërkombëtare private pa pasur një ndikim në ligjin e brendshëm. Një fushë tjetër e mundshme e konfuzionit të vazhdueshëm do të jetë dështimi për të adresuar rregulla të ndryshme të vendit në përkufizimin e "pronës martesore", e cila mund të shkel rregullat pasuese të pasurive.

## **KONKLUZION**

Me pak fjalë, duke marrë parasysh se Brukseli IV nuk është e përsosur, por ajo solli sigurisht një përmirësim të madh mbi situatën e tanishme. Duke përfshirë aftësinë e personit për të zgjedhur të drejtën kombëtare përkatëse, ajo solli një veçori shumë të rëndësishme në këtë

fushë të ndërlikuar. Rregullorja përbën një shtysë domethënëse dhe mund të themi se i ka përmbushur shumë nga qëllimet e saj. Parashikimi i ligjit të aplikueshëm, aksesit në drejtësi dhe rrjedhimisht liria e qarkullimit të njerëzve, kanë gjetur si mjet përmbushje dispozitat e Rregullores, të një kriteri gati të vetëm të kompetencës së përgjithshme dhe të ligjit në fuqi që në mënyrë të qartë sjell një kontribut të fortë për integrimin e bashkëpunimit gjyqësor në çështjet civile në Bashkimin Europian. Shtrirja universale e rregullores, jep kontribut për të arritur një uniformitetin në zgjidhjen e çështjeve të trashëgimisë në Bashkimin Europian, duke siguruar që ligji i një Shteti të tretë të jetë i zbatueshëm sipas Rregullores.<sup>204</sup>

Autonomia paraprake (edhe pse e kufizuar) mbështet lokalizimin më të mirë të trashëgimisë dhe, si e tillë, ajo plotëson nevojën e parashikueshmërisë në rregullimin e trashëgimisë, në dobi të të ndjerit, por edhe të trashëgimtarëve, legatarëve dhe kreditorëve të tij. Në këtë drejtim, instrumenti i ri zgjidh më së miri perspektivën e konfliktit të ligjeve. Dispozitat lidhur me marrëveshjet si për trashëgiminë dhe për vullnetet e përbashkëta e të ndërsjella, përcaktojnë kushtet e verifikimit të vlefshmërisë dhe, në perspektivë, lehtësojnë pranimin e tyre nga ato sisteme ligjore që ende janë kundër vlefshmërisë së marrëveshjeve në një nivel të brendshëm. Për më tepër dhe pa dyshim, përveç synimit për uniformitet dhe siguri, që institucionet e Bashkimit Europian synonin fillimisht për të trajtuar kur ata miratuan planin e veprimit europian që çoi në miratimin e Rregullores për trashëgiminë ndërkufitare.

Rregullorja duhet të arrijë një rezultat të mëtijshëm të rëndësishëm:

Modernizimin e sistemeve të konfliktit të juridiksioneve e të ligjeve të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian në çështjet e trashëgimisë. Kjo, një rrugë e vështirë, por tashme e nisur me miratimin e “vendbanimit të përhershëm” (në krahasim me kombësinë) si kriter i përgjithshëm për juridiksionin dhe ligjin në fuqi; nga ana e rëndësisë së dhënë autonomisë partiake; nga dispozitat uniforme mbi marrëveshje si psh. të trashëgimisë; nga miratimi i certifikatës europiane të trashëgimisë; si dhe nga realizimi i lëvizjes së lirë të vendimeve për çështjet e trashëgimisë, të dhëna nga gjykatat e një Shteti tjetër Anëtar.

#### Referenca:

1. “Trashëgimia në të drejtën ndërkombëtare private shqiptare”, Av. Agim Tartari.

<sup>204</sup>. Çdo aplikim i ligjeve të një shteti të tretë është ende subjekt i politikave publike.

2. “Përmbledhje e akteve ndërkombëtare për drejtësinë”, Botimi i Qendrës së Publikimeve Zyrtare.
  3. Directorate-General for Internal Policies, Policy Department c: Citizens’ rights and constitutional, Regulation (EC) n. 650/2012 of July 2012 on jurisdiction, applicable law, recognition and enforcement of authentic instruments in matters of succession and on the creation of a European Certificate of Succession.
  4. Barbara R. Hauser, artikulli “Trusts and Estates”, 2014.
  5. <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32012R0650>
  6. <http://www.boodlehatfield.com/the-firm/articles/eu-succession-law.aspx>
  7. [http://www.successions-europe.eu/en/netherlands/topics/which-law-applies\\_can-i-choose-the-applicable-law-to-my-inheritance/](http://www.successions-europe.eu/en/netherlands/topics/which-law-applies_can-i-choose-the-applicable-law-to-my-inheritance/)
  8. [http://www.hcch.net/index\\_en.php?act=conventions.pdf&cid=62](http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.pdf&cid=62)
  9. <http://www.wealthmanagement.com/estate-planning/brussels-iv-now-effect>
  10. [http://www.hcch.net/index\\_en.php?act=conventions.text&cid=41](http://www.hcch.net/index_en.php?act=conventions.text&cid=41)
- Bonomi, Successions internationales: conflits de lois et de juridictions, Recueil des Cours, vol. 350 (2011).